

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"AED COLOR" SH.P.K.



Une i nenshkruari Eduard Durolli, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise tregtare i referohem nenit 230 te Ligjit 9901 dt. 14.4.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" me qellim pershtatjen e Statuti me dispozitat e ketij Ligji.

Kreu 1

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot; me date 18/05/2011 (dymije e njembdhjete), une themeluesi, ligjeroje vazhdimesine e aktivitetit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin tregtar: "AED COLOR" SH.P.K ne perputhje me ligjin 9901 dt. 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare".

Themeluesi i shoqerise eshte:

Z. Eduard Durolli, i datl. 21.01.1947, lindur ne Fier dhe banues ne Vlore,
lagjia "28 Nentori" ;

-Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar do te vazhdoje te kete emrin tregtar "AED COLOR" Shpk.

- Adresa e shoqerise do te vazhdoje te jete ne Vlore, Fshati Skrofotine, Novosele, magazine tre kateshe, prane Rruges Vlore-Fier.
- Administratori i shoqerise do te jete **Z. Eduard Durolli**, i cili do te ushtroje kompetencat e tij per nje afat **5 vjecar me te drejte ripertertje**.

Neni 2: **Objekti**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

- Tregti import-eksport me shumice dhe pakice, bojra, llaqe, materiale ndertimi, vegla, makineri.

Neni 3: Kohegjatja

Kohegjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe kohe te pacaktuar nga momenti i nenshkrimit te ketyr statuti.

Neni 4: Selia e shoqerise

- Selia e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar: "AED COLOR" SH.P.K ndodhet ne Vlore, Fshati Skrofotine, Novosele, magazine tre kateshe, prane Rruges Vlore-Fier.

Kreu II

Kapitali i Regjistruar

Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali i shoqerise eshte 100.000,00 Lek dhe perbehet nga kontributi i ortakut te vetem si me poshte:

Z. Eduard Durolli, zoteron 100% te kuotave te kapitalit, me vlere **te barabarte me 100.000,00 leke.**

Ortaku dhe administratori i vetem i shoqerise ka te drejte ta tjetersoje kete kapital, te shtoje apo te pakesojne kuotat e kapitalit deri ne kufijte e percaktuara nga ligji.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000,00

Numri i pjeseve: 100,00

Vlera nominale: 1.000,00

Pagesat e kontributeve ne para do te kryhen ne **llogarine bankare perkatese me te cilat shoqeria operon aktualisht.**

Neni 6: Kerkesa per te paguar kuotat dhe terheqja e kuotave te papaguara

Administratori i paguan shoqerise shumen e percaktuar per kuotat e zoteruara. Njoftimi per pagese mund te parashikojte shlyerjen me keste te kontributeve te papaguara. Personi te cilit i drejtohet njoftimi per pagesen e kontributit do te jete pegjegjes per njoftimet qe i drejtohen atij pavaresisht kalimit te mepasstem te pronesise se kuotave me te cilat lidhet njoftimi per pagese.

Zoteruesit e perbashket te nje kuote do te jene pergjegjes bashkerisht dhe ne menyre solidare per shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit te mesiperm.

Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, personi pergjegjes per shlyerjen e kontributeve do te paguaje nje interes mbi shumen e paguar me nje kamatvonese prej 4% ne vit duke filluar nga dita e parashikuar per pagesen.

Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve, pagesa perkatese nuk kryhet Brenda afatit te parashikuar, Administratoret mund te njoftojne paraprakisht te pakten katermbedhete Dite te Plota personin pergjegjes per shlyerjen e kontributeve, duke i kerkuar pagesen e shumes se pashlyer se bashku me shumet e mundshme shtese te kamatvoneses. Njoftimi do te permbaje vendin ku duhet te kryhet pagesa dhe deklarimin se ne rast moszbatimi te tij, kuotat te cilave u referohet njoftimi do te anulohen.

Nese pagesa nuk kryhet brenda afatit te njoftimit, kuota me te cilin lidhet njoftimi, perpara se te kryhet pagesa e kerkuar sipas njoftimit, mund te anulohet me vendim te Administratorit dhe anullimi do te perfshije te gjitha dividendet ose shumet e tjera te pagueshme ne lidhje me kuotat e anuluarat dhe te papaguara deri ne momentin e anulimit.

Ne pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund te shitet, ti shperndahet ortakut ose te kalohet sipas afateve dhe menyrave qe Administratori konsideron te pershtatshme.

Personi, kuota e te cilit eshte anuluar, humbet cilesine e ortakut ne lidhje me kete kuote por do te jete pergjegjes ndaj shoqerise per te gjitha kontributet qe do te shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqerise ne daten e anulimit te kuotes sa bashku me kamatvonesen e llogaritur per keto kontribute perpara anulimit te kuotes.

Neni 7: Llojet e Kuotave, te Drejtave dhe Kufizimeve

Ne perputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cenuar te drejtat e rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund te emetohen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e ortakut, ne perputhje me parashikimet e nenit 87 te Ligjit Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 8: Certifikatat e kuotave

Secili ortak ka te drejte te perfitoje nje certificate per kuoten e zoteruar prej tij.

Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certificate per kuotat e zoteruara bashkarisht nga disa persona dhe dorezimi i certifikates ndaj perfaqesuesit te zoteruesve te perbashket te kuotave do te konsiderohet si dorezim i kryer ndaj te gjithë zoteruesve te kuotave,

ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditen ne çertifikaten e kuotes. Çertifikata nuk do te gezoje cilesine e letres me vlere.

Neni 9: Kalimi me Kontrate i Kuotave

Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim dhe sipas formaliteteve te percaktuara nga Administratori. Kjo kontrate do te dergohet ne seline e shoqerise.

Neni 10: Kalimi i kuotave me Trashegimi ose si pasoje e Falimentimit

Nese ortakut i shoqerise vdes, trashegimtari ose trashegimtaret ne rastin e bashkeshortit te kuotave, dhe trashegimtaret e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar i vetem i bashkeshorteve te kuotave, do te jene personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues se te drejtave mbi kuoten e tij; pavaresisht ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me persona te tjere.

Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortakut, pas paraqitjes se provave te kerkuara nga Administratori, mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjetër te caktuar prej tij si perfitues te kuotes. Nese personi i mesiperem zgjedh te behet zoterues i kuotes, ai njofton shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese ky person zgjedh qe nje person tjetër te regjistrohet si zoterues i kuotes, ai kalon ne dobi te personit tjetër.

Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortakut do te kete te drejta qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesmarrjes ose te votes ne çdo mbledhje te Ortakut te vetem apo Asamblese se Pergjithshme deri ne momentin e regjistrimit ne QKR.

Neni 11: Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar

Ortakut i vetem mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e tij ekzistuese ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Ortakut apo Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar te votave.

Neni 12: Blerja e Kuotave te Veta



Shoqeria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe Administratoret leshojnë një certifikatë të aftësisë përgjyeshme të parashikuar nga ky nen.

Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", padite mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 13: Votat e Ortakut

Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik), i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nësa ka shlyer teresisht detyrimet që kanë të bëjnë me këto kuotë.

Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendim i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyre do të jenë të vlefshme.

Neni 14: Votimi me Prokurë


Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratoret depozitohet në selinë e shoqërisë, ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emerimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyre, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Në rast se akti i emerimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*e-Mail*) sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyre në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 15: Hetimet e posaçme



Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin apo zevendesimin e nje eksperti te fushes sipas nenit 91 te Ligjit Nr.9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", paraqesin nje kerkese te tille nepermjet depozitimit te nje deklarate noteriale ne seline e shoqerise, e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi.



Kreu IV Administratoret

Neni 16: Emerimi i Administratoreve

Asambleja e Pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si Administratore te shoqerise per nje periudhe pesevjeçare, ne pajtim me parashikimet e shkronjes "c" te pikes 1 te nenit 81 dhe nenit 95 te Ligjit Nr.9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Emerimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga Asambleja e Pergjithshme, i cili nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si administrator.

Kufizimet ne lidhje me emerimin e Administratoreve parashikon ne piken 2 te nenit 95 te Ligjit Nr.9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Personi i meposhtem eshte Administratori dhe Ortaku i vetem i shoqerise.

Te dhenat e identifikimit:

(mbiemri, emri, adresa)

De velli Adnan

dhe specimenet e nenshkrimit:

Neni 17: Kompetencat e Administratorit/eve

Politikat tregtare te shoqerise do te administrohen nga Administratoret te cilet mund te ushtrojne te gjithe kompetencat qe nuk i rezervohen Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 81 te Ligjit Nr.9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Pergjithshme dhe udhezimet e Asamblese se Pergjithshme nuk do te shfuqizojne aktet e meparshme te Administratoreve, te cilat do te ishin te vlefshme nese ndryshimi nuk do te ishte kryer ose udhezimi nuk do te ishte dhene.

Administratoret nuk mund te delegojne detyrimet e tyre ligjore.

Neni 18: Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratoreve

Detyra e Administratoreve perfundon ne rast se:

1. personi nuk eshte me Administrator sipas parashikimeve te Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te po ketij Ligji;
2. personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
3. personi vuan ose mund te vuaje nga çrregullime mendore;
4. personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose
5. ka munguar per me shume se gjashte muaj radhazi pa lejen e Adminsitratoreve te tjere ne mbledhjet e Administratoreve te mbajtuar gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjithshme, me propozimin a Administratoreve, vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 19: Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratoreve

Administratoret shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e nenit 97 te Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Administratoreve mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre ligjore.

Kreu V

Dividentet dhe Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Neni 20: Dividentet

Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", shoqeria me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese se Pergjithshme mund te deklarroje shperndarjen e dividenteve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me kuotat, te gjithe dividentet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumet e paguara per kuotat per te cilet paguhet dividenti. Te gjithe dividentet pjestohen dhe paguhen ne perpjestim te drejte me shumet e paguara per kuotat, pjese ose pjeseve te periudhes per te cilen paguhet dividenti; ne rast se kuota emetohet me kushtin e perfitimit te dividentit nga nje date e caktuar, dividenti do te paguhet ne perputhje me kete kusht.



Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me kuoten.

Çdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet brenda dymbedhjete vjeteve nga data e maturimit, ne rast se vendoset me shumice te kualifikuar votash nga Asambleja e Pergjithshme, do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe ta paguaje ate.

Neni 21: Kapitimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Administratoret, pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e percaktuara ne nenin 14 te Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", mund te vendosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividende preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise.

Kreu VI Prishja dhe njoftimet

Neni 22: Prishja dhe likuidimi

Ne rast te likuidimit te shoqerise, likuiduesi, ne perputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe me vendimin e marre me shumicen e kualifikuar se votave te Asamblese se Pergjithshme, mund te shperndaje ne dobi te ortakeve te gjitha ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim, mund te vleresoje çdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shperndarjes midis ortakeve te shoqerise.

Neni 23: Njoftimet


Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve te Statutit, duhet te jene me shkrim ose (nese zbatohet) nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parashikuar sipas pikes 3 te nenit 4 te ketij Statuti dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim per personin qe kryen njoftimin.

Shoqeria mund te njoftoje nje ortak personalisht ose duke e derguar njoftimin me leter porosi me kthim pergjigje ne adresen e regjistruar te ortakut ose ne adresen apo posten elektronike (nese ka) qe i eshte njoftuar shoqerise nga ortaku. Kur ka disa bashkeshortues te nje kuote, te gjitha njoftimet i jepen perfaqesuesit te tyre te perbashket ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Ky statut se bashku me ndryshimet dhe te gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhena nga shoqeria do te publikohet nga Administratori ne faqen e internetit te shoqerise, sipas parashikimeve te pikes 2 te nenit 4 te ketij Statuti .

Ortaku Themelues:

(emer, mbiemer, nenshkrimi dhe vula)



AED-COLOR SH.P.K
L28 NENTORI -VLORE
NIPT K 48423202 U
TEL/FAX 033 232099

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
VLORE



Notere Publike MIRELA GJONÇA

Repertor Nr. 804
Koleksion Nr. 285/3

VERTETIM NENSHKRIMI

(Neni 55 i ligjit "Mbi Noterine", ndryshuar me udhezimin nr 6291 date 17.08.2005)

Ne Vlore, sot me daten 18/05/2011 (*dymije e njembehjete*), une e nenshkruara Mirela Gjonça, anetare e Dhomes se Notereve te Rrethit Vlore, me zyre noteriale ne L. "Lef Sallata", Rr. "Sadik Zotaj" Pallati i ri, kati i dyte, vertetoj se para meje u paraqit personalisht shtetasi:

Z. Eduard Durolli, i biri i Lambi dhe Ollga, i datl. 21.01.19471, lindur ne Fier dhe banues ne Vlore, lagjia "28 Nentori", madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, pa pengesa ligjore, i panjohur prej meje noteres, per identitetin e te cilit u binda ne baze te kartes se identitetit me numer serie 025454132, date leshimi 11.05.2009.

-i lartepemenduri u paraqit me cilesine e Administratorit dhe Ortakut te Vetem te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar: "AED COLOR" SH.P.K., me seli ne Vlore, Fshati Skrofotine, Novosele, magazine tre kateshe, prane Rruges Vlore-Fier.

dhe nenshkroi ne prezencen time, me vullnet te lire STATUTIN E THEMELIMIT TE SHOQERISE Date 18/05/2011 bashkangjitur.

Une noterja, pasi u binda per nenshkrimin e ketij akti e vertetoj dhe legalizoj ate.

NOTERE
MIRELA GJONÇA

